



MISIONI PËR VËZHGIMIN E ZGJEDHJEVE

Republika e Maqedonisë së Veriut - Zgjedhjet lokale, Rrethi i dytë, 31 tetor 2021

DEKLARATË PËR GJETJET DHE PËRFUNDIMET PARAPRAKE

PËRFUNDIMET PARAPRAKE

Rrethi i dytë i zgjedhjeve lokale u karakterizua nga një fushatë konkurruese në të cilën u respektuan liritë themelore, por retorika negative dhe raportimet për frikësimin e garuesve dhe presionin mbi votuesit potencialisht e tërhoqën vëmendjen nga procesi. Administrata zgjedhore bëri disa përpjekje për t'i adresuar mangësitë procedurale të vërejtura gjatë rrethit të parë, dhe dita e zgjedhjeve të rrethit të dytë kaloi pa probleme, megjithëse disa probleme vazhduan dhe mangësitë e shumta në trajtimin e kundërshtimeve i minuan mjetet efektive ligjore.

Rrethi i dytë i zgjedhjeve për kryetar të komunave u mbajt në 43 komuna dhe në qytetin e Shkupit. Vetëm 6 nga 88 kandidatët për kryetar komune që garuan në rrethin e dytë ishin gra. Në dy komuna të tjera, kërkesa për pjesëmarrje në zgjedhjet për kryetar të komunave nuk u plotësua në rrethin e parë dhe zgjedhjet për kryetar komune do të përsëriten në një datë të mëvonshme.

Komisioni Shtetëror i Zgjedhjeve (KSHZ) dhe Komisionet Zgjedhore Komunale (KZK) i kryen përgatitjet teknike për balotazhet në mënyrë adekuate dhe i respektuan afatet ligjore. KSHZ-ja organizoi trajnime për rifreskim të njohurive për zyrtarët e zgjedhjeve dhe i modifikoi formularët e protokolleve të rezultateve dhe disa procedura, në përpjekje për të trajtuar problemet që u shfaqën në rrethin e parë. Në mënyrë gjithëpërfshirëse, KSHZ-ja e zgjati periudhën e akreditimit të vëzhguesve për të gjitha organizatat që dëshirojnë ta vëzhgojnë rrethin e dytë, dhe akreditimet e lëshuara në rrethin e parë mbetën të vlefshme. Pas raundit të parë, KSHZ-ja mbajti pesë mbledhje publike, mirëpo, disa prej tyre nuk u lajmëruan paraprakisht dhe vendimet nuk u publikuan në mënyrë konsekuente, gjë që e zvogëloi transparencën e përgjithshme të procesit.

Rrethi i dytë ishte konkurrues dhe garuesit, në përgjithësi, ishin në gjendje ta zhvillonin fushatën lirshëm dhe t'i përcillnin mesazhet e tyre. Megjithatë, rastet e retorikës negative vazhduan të ndikojnë në ambientin e fushatës. Partitë kryesore i mobilizuan liderët e tyre kombëtarë për t'i mbështetur kandidatët për kryetar të komunave dhe zhvilluan ngjarje me votuesit në të gjithë vendin. Ashtu si në rrethin e parë, vëzhguesit e MVZ-së së ODIHR-it pranuan raportime të vazhdueshme, disa prej të cilave ishin të dokumentuara, për presion ndaj votuesve, duke përfshirë edhe ndaj nëpunësve publikë, për të votuar për garues të caktuar, si dhe për presion ndaj kandidatëve. MVZ-ja e ODIHR-it gjithashtu pranoi pretendime për blerje votash. Megjithëse disa hetime u iniciuan para ditës së zgjedhjeve dhe mbeten në pritje, liderët politikë në përgjithësi nuk reagueshan ndaj këtyre pretendimeve ose nuk dhanë deklaratë për t'i dekurajuar veprimet e tilla.

Nga garuesit në rrethin e dytë u kërkua që të dorëzonin raporte financiare për donacionet e pranuar një ditë përpara ditës së zgjedhjeve të rrethit të dytë, të cilat nuk u publikuan para ditës së zgjedhjeve, gjë që së bashku me mosshpalosjen e vazhdueshme të shpenzimeve të fushatës gjatë rrethit të parë, e zvogëluar transparencën. Pavarësisht nga fakti se disa garues nuk arritën t'i dorëzojnë raportet e përkohshme për financimin e fushatës për rrethin e parë, nuk u shqiptua asnjë sanksion.

Pasi që kishte më pak kandidatë në rrethin e dytë, transmetuesit e monitoruar nga MVZ-ja e ODIHR-it u ofruan votuesve informata të mjaftueshme për garuesit dhe toni i programeve të lajmeve në përgjithësi ishte neutral. Ashtu si në rrethin e parë, partitë më të vogla dhe kandidatët e pavarur patën mbulim në mediat kombëtare. Nuk u raportuan shkelje nga Agjencia për Shërbime Audio dhe Audiovizuale Mediatike ndërmjet dy rretheve zgjedhore. Ashtu si edhe në rrethin e parë, pjesa dërrmuese e kohës së transmetimit dhe mjetet financiare shtetërore për reklamim në media iu ndanë partive më të mëdha, në

përputhje me ligjin, gjë që i dëmtoi dukshëm kandidatët e partive më të vogla dhe ata të pavarur, në kundërshtim me angazhimet e OSBE-së dhe praktikat e mira ndërkombëtare.

Gjatë rrethit të parë, mosnjohja e përgjithshme nga ana e KZK-ve e procedurave për trajtimin e kundërshtimeve të parashtruara nga votuesit në lidhje me të drejtën e tyre për të votuar çoi në zbatimin jokonsekuent të tyre, dhe si rezultat i kësaj, një numër i kundërshtimeve të tilla nuk u trajtuan, duke i privuar këta votues nga mundësia për të votuar dhe duke e minuar kështu mjetin efektiv ligjor. Pas rrethit të parë, KSHZ-ja pranoi 12 kundërshtime nga garuesit në lidhje me rezultatet e zgjedhjeve, mirëpo të gjitha ato u refuzuan ose u hodhën poshtë, shpesh duke mos e marrë parasysh përmbajtjen ashtu siç duhet. Mangësitë e shumta në trajtimin e ankesave në KSHZ, duke përfshirë zbatimin formalist ose jokonsekuent të kërkesave për pranueshmërinë e tyre, e minuan të drejtën për mjet efektiv ligjor.

MVZ-ja e ODIHR-it nuk i vëzhgoi procedurat e ditës së zgjedhjeve në rrethin e dytë në mënyrë sistematike ose gjithëpërfshirëse, por anëtarët e misionit vizituan një numër të kufizuar vendvotimesh. Procesi i votimit në vendvotimet e vizituara u vlerësua se ishte i organizuar mirë, transparent dhe i qetë, megjithëse autoritetet raportuan incidente të izoluara. Megjithëse procedurat e përcaktuara u respektuan në masë të madhe, vazhduan disa probleme të vërejtura në rrethin e parë, duke përfshirë problemet teknike me identifikimin biometrik të votuesve. Numërimet e pakta të votave që u vëzhguan ishin kryesisht transparente, por respektimi i procedurave të përcaktuara ndryshonte ndjeshëm. KSHZ-ja njoftoi se pjesëmarrja në votime ishte 48.6 për qind dhe filloi t'i publikojë rezultatet preliminare menjëherë pas mbylljes së votimit, duke e rritur kështu transparencën.

GJETJET PARAPRAKE

Sfondi dhe zhvillimet pas rrethit të parë

Më 23 dhe 26 tetor, Komisioni Shtetëror i Zgjedhjeve (KSHZ) i shpalli rezultatet përfundimtare të rrethit të parë të zgjedhjeve lokale të mbajtura më 17 tetor.¹ Në rrethin e parë u zgjodhën tridhjetë e katër kryetarë të komunave. Prej tyre, 22 ishin kandidatë të Organizatës së Brendshme Revolucionare Maqedonase – Partia Demokratike për Unitetin Kombëtar Maqedonas (VMRO-DPMNE), 9 të Lidhjes Social Demokrate të Maqedonisë (LSDM), dhe 3 të Bashkimit Demokratik për Integrim (BDI). Në komunat e Qendrës së Zhupës dhe të Mavrovës dhe Rostushës, nuk u përmbush kërkesa ligjore që një e treta e votuesve të regjistruar të dalin në zgjedhje, në mënyrë që zgjedhjet për kryetar komune të jenë të vlefshme; zgjedhjet për kryetar komune në këto dy komuna do të përsëriten në një datë të mëvonshme.

Në përputhje me ligjin, KSHZ-ja e caktoi rrethin e dytë të zgjedhjeve për kryetar të komunave për më 31 tetor në qytetin e Shkupit dhe në 43 komuna, duke përfshirë Manastirin, Gostivarin, Kumanovën dhe Tetovën.² Nga 88 kandidatët për kryetar komune që garuan në rrethin e dytë, 6 ishin të pavarur. Nga 25 femra kandidatë për kryetare komune, asnjëra nuk u zgjodh në rrethin e parë dhe vetëm 6 kaluan në rrethin e dytë. Në komunën e Dibrës, zgjedhjet për kryetar komune u përsëritën më 31 tetor në një vendvotim, në të cilin u anulua rrethi i parë (shih *Administrimi i zgjedhjeve*).³

¹ KSHZ-ja e shpalli shumicën e rezultateve më 23 tetor; rezultatet në katër gara për kryetar komune dhe në shtatë gara për Këshillat komunalë u shpallën pas skadimit të afateve përkatëse për shqyrtim të kontesteve.

² Në Shuto Orizare, rrethi i dytë i zgjedhjeve për kryetar komune u mbajt më 31 tetor, dhe në një vendvotim ku rrethi i parë i votimit u shpall i pavlefshëm, votuesit votuan edhe për Këshillin e komunës dhe për Këshillin e Qytetit të Shkupit. Ndër komunat më të mëdha, vetëm Prilepi, Shtipi, Velesi dhe komunat e Gazi Babës dhe Aerodromit në Shkup i zgjodhën kryetarët e tyre në rrethin e parë.

³ Pas përsëritjes së votimit në atë vendvotim më 31 tetor, asnjë kandidat nuk fitoi shumicën absolute të nevojshme për t'u zgjedhur në rrethin e parë, dhe rrethi i dytë do të mbahet më vonë në të gjithë komunën.

Pas rrethit të parë, përfaqësuesit e VMRO-DPMNE-së i bënë thirrje kryeministrit Zoran Zaev të japë dorëheqje, kurse disa parti opozitare kërkuan zgjedhje të parakohshme parlamentare. Kryeministri e përmendi Raportin e progresit të Komisionit Evropian të lëshuar më 19 tetor dhe theksoi se partia e kishte vazhduar të mbajë një ritëm të vendosur në avancimin e reformave në lidhje me BE-në.

Administrimi i zgjedhjeve

Garat për kryetar të komunave në rrethin e dytë u administruan nga KSHZ-ja, 50 Komisione Zgjedhore Komunale (KZK) dhe Komisioni Zgjedhor i Qytetit të Shkupit (KZQSh), 2,394 Këshilla Zgjedhorë (KZ) dhe 42 Këshilla zgjedhorë të veçantë. Përbërja e organeve zgjedhore të nivelit të ulët mbeti kryesisht e pandryshuar, me përjashtim të disa dorëheqjeve për arsye shëndetësore. KSHZ-ja shkarkoi në tërësi dy KZ dhe disa anëtarë të KZK-së në Dibër, për shkak të mangësive procedurale që çuan në anulimin e rezultateve të vendotimeve përkatëse.⁴

KSHZ-ja dhe KZK-të i kryen përgatitjet teknike për balotazhet në mënyrë adekuate dhe i respektuan afatet ligjore. Pas rrethit të parë, kolegjaliteti i punës së Komisionit herë pas herë u minua për shkak të mungesës së koordinimit të brendshëm dhe shkëmbimit të informatave. Në kundërshtim me kërkesat e parapara në Kodin Zgjedhor, kërkesat e dorëzuara nga një anëtar i KSHZ-së për të shqyrtuar të gjithë materialin zgjedhor të një vendvotimi ku votimi ishte anuluar dhe për të bërë një krahasim të plotë të gjurmëve të mbledhura të gishtave të votuesve nuk u morën parasysh. KSHZ-ja mbajti pesë mbledhje publike të dedikuara për zgjidhjen e kundërshtimeve në lidhje me ditën e parë të zgjedhjeve, organizimin për rrethin e dytë dhe shpalljen e rezultateve të zgjedhjeve. Për shkak të problemeve teknike me transmetimin e drejtpërdrejtë në KSHZ, incizimet e dy prej këtyre mbledhjeve ishin në dispozicion vetëm në ueb-faqen e Agjencisë shtetërore të lajmeve (MIA). Disa mbledhje, duke përfshirë edhe ato për shpalljen e rezultateve përfundimtare të rrethit të parë dhe për modifikimet e disa procedurave, nuk u lajmëruan paraprakisht. Megjithatë për shumicën e mbledhjeve u publikuan informacione të shkurtra në ueb-faqen e saj, që nga XX tetori, KSHZ-ja nuk publikoi informacion adekuat për vendimet e saj të marra në mbledhjet e mbajtura që nga fundi i shtatorit, gjë që zvogëloi transparencën e punës së saj.⁵

Duke pasur parasysh incidencën e lartë të protokolleve të rezultateve që kërkonin korrigjim në rrethin e parë, që ishte tregues i mosnjohjes së mjaftueshme të procedurave nga ana e zyrtarëve të zgjedhjeve, KSHZ-ja i modifikoi formularët e protokolleve të rezultateve, duke e hequr një formulë të gabuar për kontrollim dhe duke shtuar shpjegime për disa pika. Megjithatë, ky rregullim nuk i trajtoi plotësisht çështjet me të cilat u përballën KZK-të në ditën e zgjedhjeve. Kjo, kryesisht, ishte rezultat i asaj se aplikacioni i KSHZ-së për transmetimin elektronik të rezultateve nuk ishte përshtatur për t'u lejuar KZK-ve ta përditësojnë numrin e përgjithshëm të votuesve të regjistruar nëse kishte persona që ishin shtuar në Listën Zgjedhore në ditën e zgjedhjeve në bazë të ankesës së pranuar. Duke iu referuar vendimit të Gjykatës Administrative për anulimin e votimit në rrethin e parë në një vendvotim në Shuto Orizare, më 26 tetor KSHZ-ja vendosi ta ndryshojë udhëzimin e saj për vlefshmërinë e fletëvotimeve, duke njoftuar se fletëvotimet pa vulë zyrtare do të konsiderohen të vlefshme në rrethin e dytë, duke hequr kështu një mjet mbrojtës të rëndësishëm procedural për ta garantuar integritetin e fletëvotimit. Ky vendim i KSHZ-së u anulua të nesërmen.

Për të trajtuar mangësitë e tjera procedurale të vërejtura në rrethin e parë, KSHZ-ja gjithashtu i përditësoi edhe procedurat që zbatohen për identifikimin e votuesve dhe për paketimin e materialeve zgjedhore dhe organizoi sesione trajnimi për rifreskim të njohurive për KKZ-të dhe për kryetarët e KZ-ve dhe zëvendësit

⁴ Në vendvotimin 0543 në Dibër, ku 172 votues (rreth 22 për qind e votuesve të regjistruar në këtë vendvotim) nuk u njohën nga pajisja për identifikimin biometrik të votuesve, as anëtarët e KZ-së, përveç kryetarit, e as anëtarët e KZK-së nuk e nënshkruan protokollin, duke e bërë kështu protokollin e rezultateve të pavlefshëm. Në vendvotimin 2957/1 në Shuto Orizare, një numër i konsiderueshëm i fletëvotimeve u shpallën të pavlefshme për shkak se nuk ishin të vulosura me vulën zyrtare të KZ-së para se t'u jepen votuesve.

⁵ Kjo ka të bëjë me shtatë mbledhje të mbajtura që nga 24 shtatori.

e tyre. Trajnimet u fokusuan në procedurat e votimit, udhëzimet operative për pajisjet biometrike për identifikimin e votuesve (PIBV) dhe plotësimin e protokolleve të rezultateve. Sesionet e trajnimit që u vëzhguan nga MVZ-ja e ODIHR-it ishin, në përgjithësi, të organizuara mirë dhe informuese, duke u dhënë zyrtarëve të zgjedhjeve mundësinë për të parashtruar pyetje dhe për t'i sqaruar dyshimet në lidhje me procedurat zgjedhore.

Kodi Zgjedhor nuk parashikon përditësimin e Listave Zgjedhore ndërmjet rrethëve zgjedhore, me përjashtim të rasteve të votuesve që e dëshmojnë të drejtën e tyre për të votuar në ditën e zgjedhjeve në bazë të ankesës së pranuar.⁶ Sipas KSHZ-së, në ditën e zgjedhjeve të rrethit të parë, u regjistruan rreth 222 votues në bazë të vendimeve të KZK-ve. Edhe pse KSHZ-ja kishte planifikuar të kryente një verifikim mbarëkombëtar të gjurmëve të mbledhura të gishtërinjve të votuesve pas rrethit të parë, një verifikim i tillë nuk u krye, për shkak të kufizimeve logjistike dhe mospërputhjeve në mbledhjen dhe cilësinë e të dhënave të gjurmëve të gishtërinjve. Listat Zgjedhore elektronike, u ringarkuan, pa ndryshime, në PIBV-të ndërmjet 19 dhe 23 tetorit, ndërsa pajisjet u shpërndanë KZK-ve më 28 dhe 29 tetor. Trajnimet e rrethit të dytë u mundësuan trajnuesve të KSHZ-së që në mënyrë efektive t'i përparojnë përvojat me procedurat e reja të identifikimit të votuesve, gjë që e përmirësoi qartësinë e trajnimeve të ofruara.

Në mënyrë gjithëpërfshirëse, KSHZ-ja e zgjati periudhën e akreditimit të vëzhguesve për të gjitha organizatat që dëshirojnë të vëzhgojnë rrethin e dytë, por pa një afat të caktuar. Akreditimet e lëshuara në rrethin e parë për vëzhguesit dhe gazetarët e huaj, si dhe për përfaqësuesit e garuesve në zgjedhje që garuan në rrethin e dytë, mbetën të vlefshme edhe për balotazhin. Një grup vëzhguesish qytetarë, CIVIL - Qendra për Liri, e informoi MVZ-në e ODIHR-it se disa nga vëzhguesit e tyre ishin penguar në punën e tyre gjatë ditës së zgjedhjeve të rrethit të parë, duke vënë në dukje mungesën e njohjes së procedurave nga anëtarët e KZ-ve, por gjithashtu duke përmendur edhe faktin se distinktivët e tyre si vëzhgues të lëshuara nga KSHZ-ja nuk i përmbanin të dhënat e kërkuara personale për identifikim. Si reagim ndaj njoftimeve të CIVIL-it dhe Shoqatës së Gazetarëve të Maqedonisë, përfaqësuesve të së cilës gjithashtu u ishte ndaluar qasja në disa vendvotime, KSHZ-ja u bëri thirrje të gjithë zyrtarëve të zgjedhjeve që ta respektojnë detyrimin e tyre ligjor për ta lehtësuar qasjen për të gjithë personat e akredituar në të gjitha fazat e procesit zgjedhor dhe t'u mundësojnë mediave ta kryejnë punën e tyre brenda vendvotimeve.⁷

Fushata dhe financimi i fushatës

Fushata e rrethit të dytë filloi më 18 tetor dhe përfundoi më 29 tetor në mesnatë. Garuesit i vazhduan fushatat e tyre menjëherë pas rrethit të parë. Rrethi i dytë ishte konkurrues dhe garuesit, në përgjithësi, ishin në gjendje ta zhvillonin fushatën lirshëm dhe t'i përcillnin mesazhet e tyre. Megjithatë, rastet e retorikës negative vazhduan të ndikojnë në atmosferën e përgjithshme, ku partitë kryesore u përfshinë në sulme të ndërsjella.⁸ Më 27 tetor, kryeministri dhe kryetar i LSDM-së, në një intervistë për media bëri pretendime të pabazuara se Danella Arsovska, kandidatja e pavarur për kryetare të Qytetit të Shkupit e mbështetur nga VMRO-DPMNE-ja, kishte shtetësi bullgare dhe i bëri thirrje asaj të tërhiqej.

⁶ Kodi Zgjedhor kërkon që Ministria e Punëve të Brendshme (MPB) t'i ofrojë KSHZ-së të dhëna, para mbylljes së regjistrimit të votuesve për rrethin e parë, për personat të cilëve u ka skaduar afati i letërnjoftimit pas shpalljes së zgjedhjeve dhe për personat të cilët kanë mbushur moshën 18 vjeç ndërmjet dy rrethëve zgjedhore. Në përputhje me ligjin, në Listat zgjedhore u përfshinë rreth 40,000 qytetarë të cilëve u ka skaduar letërnjoftimi pas shpalljes së zgjedhjeve. Megjithatë, pasi që Kodi Zgjedhor i ndalon përditësimet administrative të Listave Zgjedhore ndërmjet dy rrethëve, personat që mbushën moshën 18 vjeç ndërmjet dy rrethëve zgjedhore duhej të parashtronin ankesë për t'u shtuar në lista.

⁷ [Apeli](#) u publikua nga një numër i mediave. Në ditën e zgjedhjeve të rrethit të dytë, në një konferencë për shtyp, kryetari i KSHZ-së e përsëriti këtë apel në përgjigje të raportimeve se gazetarëve nuk u është lejuar hyrja në vendvotime.

⁸ Në një [deklaratë publike pas mbylljes së vendvotimeve më 17 tetor](#), kryetari i partisë dhe kryeministri Zoran Zaev la të kuptohej se VMRO-DPMNE-ja përfaqëson “të keqen”; Kryetari i VMRO-DPMNE-së, Hristijan Mickoski, nga ana e tij, gjatë një takimi të fushatës në Shkup më 20 tetor, [deklaroi](#) se “qeveria nuk ka kuptuar asgjë, por vazhdon me shantazhe, kërcënime, keqpërdorim të policisë në zgjedhje (dhe) blerje votash”.

Shumica e partive bënë me dije se i përshtatën strategjitë e tyre të fushatës për rrethin e dytë në favor të takimeve të vogla dhe aktiviteteve derë-më-derë në vend të tubimeve më të mëdha. Garuesit vazhduan të zhvillojnë aktivitetet të gjerë në platformat e mediave sociale. Partitë kryesore i mobilizuan liderët e tyre kombëtarë për t'i mbështetur kandidatët për kryetar të komunave dhe zhvilluan ngjarje me votuesit në të gjithë vendin, me ç'rast mesazhet kyçe ishin të fokusuar në shëndetësi, arsim dhe infrastrukturë. Disa garues kërkuan në mënyrë aktive të fitojnë mbështetje nga bashkësitë më të vogla etnike ose jashtë bazës së tyre tradicionale mbështetëse. Për shembull, në një tubim në Shkup më 23 tetor, një kandidat i LSDM-së iu drejtua votuesve me mesazhe në gjuhën maqedonase, shqipe dhe rome, ndërsa kandidati për kryetar komune të Tetovës dhe kryetar i partisë kryesisht etnike-shqiptare, BESA, publikoi materiale të fushatës online në gjuhën maqedonase.

Ashtu si në rrethin e parë, MVZ-ja e ODIHR-it pranoi raportime të vazhdueshme për presione ndaj votuesve, duke përfshirë ndaj policëve dhe nëpunësve të tjerë publikë, për të votuar ose mbështetur garues të caktuar.⁹ Për më tepër, MVZ-ja e ODIHR-it pranoi pretendime të vazhdueshme për frikësim dhe presion mbi disa kandidatë, duke përfshirë edhe nga zyrtarët e policisë.¹⁰ Sindikata e Policisë së Maqedonisë lëshoi një deklaratë më 27 tetor, duke u bërë thirrje partive politike që të përmbahen nga presioni ndaj policëve dhe anëtarëve të njësive policore që të mos u shërbejnë interesave të partive politike.¹¹ MVZ-ja e ODIHR-it gjithashtu pranoi pretendime për blerje votash. Megjithëse disa hetime u iniciuan para ditës së zgjedhjeve, liderët politikë në përgjithësi nuk reagues ndaj këtyre pretendimeve ose nuk dhanë deklarata për t'i dekurajuar veprimet e tilla.¹²

Pas rrethit të parë, Komisioni Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit (KSHPK) refuzoi një kundërshtim nga VMRO-DPMNE-ja për keqpërdorim të supozuar të burimeve shtetërore nga qeveria.¹³ Vendimi i KSHPK-së u vërtetua nga Gjykata Administrative. KSHPK-ja e informoi MVZ-në e ODIHR-it për nëntë raportime në lidhje me keqpërdorimin e supozuar të burimeve publike gjatë fushatës së rrethit të dytë, me ç'rast shumica kishin të bëjnë me punësimin e personelit në institucionet publike ose fillimin e projekteve publike për ndërtim gjatë periudhës zgjedhore. Meqenëse këto raportime nuk janë dorëzuar nga garuesit, ato nuk janë trajtuar si kundërshtime të cilat duhet të trajtohen në mënyrë të përshtetshme, dhe nuk u ndërmor asnjë veprim para rrethit të dytë, gjë që e minoi mjetin efektiv ligjor.

Nga garuesit në rrethin e dytë u kërkuar që të dorëzonin raport financiar për donacionet e pranuar një ditë përpara ditës së zgjedhjeve të rrethit të dytë.¹⁴ Edhe pse shumica e garuesve e respektuan kërkesën për raportim, këto raporte nuk u publikuan para ditës së zgjedhjeve, dhe për këtë arsye nuk kishte në dispozicion publikisht asnjë informacion në lidhje me burimet e financimit të garuesve gjatë balotazhit, gjë që e zvogëloi transparencën. Raportet e dyta të përkohshme nga rrethi i parë të cilat duhej të dorëzohen më 16 tetor, me informacione të mëtejshme për donacionet e garuesve nga personat fizikë dhe juridikë, u publikuan nga Enti Shtetëror i Revizionit (ESHR) më 19 tetor, dy ditë pas ditës së parë të

⁹ Vëzhguesit e MVZ-së së ODIHR-it pranuan pretendime se policët në një komunë afër Shkupit ishin thirrur në takime me zyrtarë të MPB-së dhe u ishte kërkuar të votonin për kandidatin e BDI-së.

¹⁰ Kandidati i pavarur për kryetar të komunës së Kumanovës, kryetari aktual Maksim Dimitrievski, pretendoi publikisht se është bërë presion dhe frikësim ndaj fushatës së tij nga Ministri i Punëve të Brendshme, Oliver Spasovski, dhe nga Krye-shefi i Policisë së Kumanovës. Kandidati i pavarur dhe kryetari aktual i Komunës së Debarcës, Zoran Nogaçeski, në një postim në rrjetet sociale, pretendoi se kundërshtari i tij nga LSDM-ja ka bërë presion ndaj votuesve.

¹¹ Shih [deklaratën e plotë](#) (në gjuhën maqedonase).

¹² MPB-ja më 30 tetor njoftoi se dy persona janë arrestuar në Shkup nën dyshimin për blerje votash. Në të njëjtën ditë, Prokuroria Themelore Publike në Koçan hapi një hetim në bazë të denoncimeve të dy partive politike për presion ndaj votuesve.

¹³ Ankuesi e kontestoi dhënien e mbështetjes financiare nga qeveria për 160 kompani tregtare, 4 ditë para ditës së zgjedhjeve të rrethit të parë. Si KSHPK-ja ashtu edhe Gjykata Administrative konstatuan se veprimet e qeverisë ishin të ligjshme, ndër të tjera, pasi që gjatë periudhës zgjedhore nuk ishin bërë pagesa faktike për kompanitë dhe se këto pagesa të pritura ishin paraparë në buxhetin e shtetit për vitin 2021.

¹⁴ Një raport tjetër që ka të bëjë me rrethin e dytë duhet të dorëzohet më 19 nëntor.

zgjedhjeve.¹⁵ Pavarësisht nga fakti se disa garues nuk arritën t'i dorëzojnë raportet e përkohshme për financimin e fushatës për rrethin e parë, nuk u shqiptua asnjë sanksion.¹⁶ KSHPK-ja raportoi se nuk kishte identifikuar asnjë shkelje të rregulloreve për financimin e fushatës gjatë fushatave për rrethin e parë apo të dytë.

Mediat

Sikurse edhe në rrethin e parë, mediat ishin të obliguara t'i mbulojnë zgjedhjet në mënyrë të balancuar dhe të paanshme. Fondet shtetërore për reklamim në media dhe për ndarjen e kohës së transmetimit u shpërndanë midis garuesve sipas formulës së njëjtë që u zbatua edhe në rrethin e parë; dy partitë më të mëdha parlamentare në pushtet dhe dy partitë më të mëdha parlamentare të opozitës marrin 90 për qind të fondeve të alokuara, kurse 7 për qind u ndahen partive më të vogla parlamentare dhe 3 për qind partive joparlamentare dhe kandidatëve të pavarur.¹⁷ Kjo shpërndarje, në kontekstin e balotazheve për kryetarë të komunave, e shtrembëroi ndjeshëm terrenin për garë, në garat ku kishte kandidatë të pavarur ose kandidatë që përfaqësojnë parti më të vogla ose joparlamentare, që është në kundërshtim me angazhimet e OSBE-së dhe praktikat e mira ndërkombëtare. Ashtu si në rrethin e parë, nuk u publikua asnjë vendim zyrtar për ndarjen e buxhetit.

Më 18 tetor, Agjencia për Shërbime Audio dhe Audiovizuale Mediatike (ASHAAM) vazhdoi monitorimin e saj të mediave dhe raportimin ditor në KSHZ. Nga ASHAAM-i nuk është raportuar asnjë shkelje ndërmjet dy rretheve zgjedhore. Në ditën e zgjedhjeve të rrethit të parë dhe në ditët pas saj, disa gazetarë u kritikuan nga politikanët dhe zyrtarët publikë për mbulimin e rrethit të parë nga ana e tyre.¹⁸

Toni i mbulimit në programet e lajmeve të të gjithë transmetuesve të monitoruar ishte në përgjithësi neutral. Në programet e lajmeve në të gjitha kanalet e monitoruara dominonte mbulimi i LSDM-së dhe i VMRO-DPMNE-së, dhe këto dy parti ishin më të spikaturat në reklamat e paguara politike.¹⁹ *Alsat-M* emetoi reklama të shumta me pagesë nga BDI-ja dhe koalicioni i Aleancës për Shqiptarët dhe Alternativës. Në shumicën e kanaleve të monitoruara, partitë më të vogla dhe kandidatët e pavarur patën mbulim të caktuar, duke përfshirë jashtë programeve të lajmeve, në programet për çështjet aktuale dhe debatet e organizuara.²⁰ Pasiqë kishte më pak kandidatë në rrethin e dytë, transmetuesit e monitoruar u ofruan votuesve informata të mjaftueshme për garuesit

¹⁵ Ndonëse nuk kërkohet me ligj, disa garues dhanë informacion mbi burimet e tjera të financimit, përveç donacioneve, duke përfshirë edhe përdorimin e mjeteve financiare të partive politike.

¹⁶ Kodi Zgjedhor parashikon sanksion prej 9,000 eurosh për mosdorëzimin e raporteve për financimin e fushatës.

¹⁷ Buxheti për zhvillim të fushatës në media nuk mund të kalojë 1 euro për votues në komunat ku mbahet rrethi i dytë. Në garat e rrethit të dytë ku kandidatët e pavarur garonin kundër kandidatëve nga partitë më të mëdha parlamentare, të parët morën 3 për qind të mjeteve financiare që ishin në dispozicion, ndërsa të dytët morën deri në 45 për qind. Mjetet e mbetura financiare duhet të kthehen në buxhetin e shtetit.

¹⁸ Për shembull, një kandidat i pavarur për kryetar komune në komunën e Kërçovës, i tha gazetares së *TV21* që ishte e pranishme në selinë e fushatës së tij: “Ju jeni gjëja më e keqe që ju ka ndodhur qytetarëve, ju jeni gjakatarë. Është faji juaj që Kërçova ka arritur në këtë gjendje ku është. Ju jeni me qeverinë dhe punoni në mënyrë të njëanshme”. Një gazetarë t *TV Klan* gjatë periudhës zgjedhore është përballur me akuza se gjoja e ka shantazhuar kandidatin e Aleancës për Shqiptarët (AA) për kryetar të komunës së Tetovës. Shoqata e Gazetarëve të Maqedonisë (SHGM) raportoi një tentim për të diskredituar një gazetar tjetër të *TV Klan* nga Ministri i Punëve të Jashtme në një konferencë për shtyp, si dhe disa raste kur mediat online u penguan për të raportuar ditën e zgjedhjeve të rrethit të parë nga mbështetësit e partive politike. Më 21 tetor, u lëshua një [Deklaratë e Përbashkët](#) nga Përfaqësuesi i OSBE-së për Lirinë e Mediave, Raportuesi Special i OKB-së për Mbrojtjen dhe Promovimin e Lirisë së Mendimit dhe të Shprehjes, Raportuesi Special i Organizatës së Shteteve Amerikane për Lirinë e Shprehjes, dhe Raportuesi Special për Lirinë e Shprehjes dhe Qasjen në Informata i Komisionit Afrikan për të Drejtat e Njeriut dhe të Popullit, që denonconte deklaratat publike të politikanëve dhe të zyrtarëve publikë që “kërcënojnë ose inkurajojnë sulme ndaj gazetarëve, mbrojtësve të të drejtave të njeriut dhe i vendosin pakicat në rrezik”.

¹⁹ LSDM-ja pati kohë transmetimi prej 17 deri në 31 për qind në programet e lajmeve të kanaleve private të monitoruara; VMRO-ja pati prej 13 deri në 21 për qind.

²⁰ Danella Arsovska (Shkup) dhe Maksim Dimitrievski (Kumanovë) morën pothuajse të gjithë mbulimin kombëtar të kandidatëve të pavarur në programet e lajmeve të kanaleve të monitoruara.

Kundërshtimet dhe ankesat

Në ditën e zgjedhjeve të rrethit të parë, u parashtruan mbi 300 kundërshtime nga votuesit, në lidhje me të drejtën e tyre për të votuar.²¹ Përderisa në disa raste KZK-të vepruan në kohë në lidhje me kundërshtimet e tilla, shumë prej tyre u trajtuan pas afatit, kryesisht për shkak të vonesave në komunikim me KSHZ-në.²² Sistemi elektronik i KSHZ-së për dorëzimin e kundërshtimeve nuk u përditësuar vazhdimisht, gjë që rezultoi me informacion të kufizuar publik. Përveç kësaj, mungesa e njohjes së procedurave për trajtimin e kundërshtimeve në radhët e KZK-ve, çoi në zbatimin jokonsekuent të tyre; megjithëse KZK-të, në përgjithësi, ishin të përfshira në përpunimin e kundërshtimeve, shumë prej tyre u përmbajtën nga shqyrtimin i tyre dhe ia përcollën këto kundërshtime KSHZ-së për të marrë vendim. Si rezultat i kësaj, një numër kundërshtimesh në lidhje me të drejtën e votës nuk u trajtuan, duke i privuar ata votues nga mundësia për të votuar dhe duke i minuar mjetet efektive ligjore. MVZ-ja e ODIHR-it vërejti se në rastet ku KZK-të e morën përsipër t'i shqyrtonin ankesat, ato shpesh nuk u shqyrtuan në mbledhje publike e as në mënyrë kolegjiale. Para rrethit të dytë, KSHZ shqyrtoi edhe 122 kundërshtime të tjera nga votuesit në lidhje me të drejtën e tyre për të votuar dhe votimin në shtëpi.²³

Pas rrethit të parë, KSHZ-ja shqyrtoi 14 kundërshtime, 2 në lidhje me shkeljen e heshtjes zgjedhore dhe 12 në lidhje me rezultatet, të gjitha të parashtruara nga garuesit.²⁴ Të gjitha këto u refuzuan ose u hodhën poshtë, shpesh pa marrë parasysh thelbin e kundërshtimit dhe provat e ofruara në lidhje me shkeljen e pretenduar.²⁵ Tre kundërshtime u hodhën poshtë për shkak se u parashtruan nga përfaqësues të paautorizuar të garuesve, pa u dhënë mundësi garuesve që t'i ri-dorëzonin kundërshtimet nga përfaqësuesit e tyre të autorizuar ligjorisht;²⁶ katër kundërshtime u hodhën poshtë për shkak se u dorëzuan pas afatit.²⁷ Megjithëse të gjitha kundërshtimet u shqyrtuan në mbledhje publike, palët e përfshira në rast nuk u ftuan të marrin pjesë në to, kurse disa mbledhje nuk u transmetuan online. Në përgjithësi, mangësitë e shumta në trajtimin e kundërshtimeve në KSHZ, e minuan të drejtën për mjet efektiv ligjor.

Për dy vendime të KSHZ-së për rezultatet e rrethit të parë u parashtruan ankesa në Gjykatën Administrative; të dy vendimet u anuluan, dhe rezultatet në dy vendvotime në Dibër dhe në Shuto Orizare u anuluan.

Sipas Prokurorisë Publike të Shtetit, pas ditës së zgjedhjeve të rrethit të parë, policia dhe prokurorët pranuan disa denoncime për sjellje të mundshme kriminale të lidhura me zgjedhjet, me ç'rast shumica

²¹ Sipas KSHZ-së, rreth 222 nga këto kundërshtime u pranuan. Këto ankesa mund të dorëzoheshin personalisht në KZK ose në mënyrë elektronike. Deri më 30 tetor, KSHZ-ja nuk ishte në gjendje ta konfirmonte numrin e përgjithshëm të kundërshtimeve për rrethin e parë për shkak të një numri të dukshëm të kundërshtimeve të dyfishta, të parashtruara edhe personalisht edhe në mënyrë elektronike.

²² KZK-të nuk kanë qasje në regjistrin e votuesve dhe atyre u kërkohet që t'i verifikojnë të dhënat e votuesve përmes KSHZ-së. Numri i madh i kërkesave të tilla në ditën e zgjedhjeve çoi në grumbullim të konsiderueshëm të tyre në KSHZ, e që u përkeqësua edhe më tej për shkak të problemeve teknike. Disa KZK e informuan MVZ-në e ODIHR-it se kishin pranuar informacionin e nevojshëm vetëm pak para përfundimit të votimit.

²³ Nga këto, 82 u miratuan.

²⁴ Pesëmbëdhjetë 15 kundërshtime në lidhje me rezultatet u tërhoqën, duke i përfshirë edhe kundërshtimet e dorëzuara nga AA-ja, BDI-ja, LSDM-ja dhe VMRO-DPMNE-ja. Disa garues e informuan MVZ-në e ODIHR-it se kundërshtimet e tyre u tërhoqën në pritje të refuzimit për mungesë provash për shkak të kriterëve të rrepta ligjore për pranueshmërinë e provave, si dhe për shkak të mungesës së besimit në sistemin për zgjidhjen e kontesteve zgjedhore.

²⁵ Në disa raste, KSHZ-ja refuzoi t'i mernte në konsideratë provat e ofruara për shkak të mungesës së vërejtjes në protokollin e rezultateve ose i refuzoi kundërshtimet për shkak të mungesës së provave, pa u përpjekur të shqyrtonte siç duhet provat e ofruara nga aplikuesi, pavarësisht nga një rekomandim i mëparshëm i ODIHR-it.

²⁶ Seksioni II.3.3b i Kodit të Praktikës së Mirë në Çështjet Zgjedhore rekomandon se “procedura duhet të jetë e thjeshtë dhe pa formalitete, veçanërisht për sa i përket pranueshmërisë së ankesave.”

²⁷ Megjithëse dy kundërshtimet e hedhura poshtë kontestonin çështje që kishin të bëjnë me nxjerrjen e rezultateve, dhe rrjedhimisht, sipas ligjit, ato mund të parashtrohen brenda 48 orëve nga shpallja e rezultateve, KSHZ-ja në vendimet përkatëse ka theksuar se këto kundërshtime është dashur të dorëzohen brenda 48 orëve nga mbyllja e votimit.

prej tyre pretendonin si ishte bërë presion ndaj votuesve dhe blerje e votave; deri më 29 tetor, të gjitha këto mbetën nën hetim.

Dita e zgjedhjeve

Në përputhje me metodologjinë e ODIHR-it, në mungesë të vëzhguesve afatshkurtër për rrethin e dytë, MVZ-ja e ODIHR-it nuk i vëzhgoi procedurat e ditës së zgjedhjeve në mënyrë sistematike ose gjithëpërfshirëse, por anëtarët e misionit vizituan një numër të kufizuar vendvotimesh në Qytetin e Shkupit dhe në 17 komuna. Në numrin e kufizuar të vendvotimeve të vizituara, procesi i votimit në përgjithësi u vlerësua se ishte i organizuar mirë, transparent dhe i qetë. Procedurat e përcaktuara u respektuan në masë të madhe, por në disa raste të pakta, fshehtësia e votës nuk u respektua plotësisht. Vazhduan disa probleme të vëzhguara në rrethin e parë, duke përfshirë rastet e shpeshta kur pajisjet biometrike të identifikimit nuk arrinin të bëjnë skanimin e suksesshëm të gjurmëve të gishtave të votuesve në vendvotimet e vizituara. Janë vërejtur disa raste të shkeljes së heshtjes zgjedhore. Masat mbrojtëse kundër KOVID-19 ishin vendosur, por distanca fizike nuk respektohej gjithmonë dhe pajisjet mbrojtëse personale nuk përdorreshin vazhdimisht. Numërimet e pakta të votave që u vëzhguan ishin kryesisht transparente, por respektimi i procedurave të përcaktuara ndryshonte ndjeshëm ndërmjet vendvotimeve të vizituara, dhe disa KZ kishin probleme me plotësimin e protokollit të rezultateve.

KSHZ-ja njoftoi se pjesëmarrja e votuesve ishte 48.6 për qind. Ashtu si në rrethin e parë, KSHZ-ja ndau informacione të përditësuara në lidhje me procesin e votimit gjatë gjithë ditës së zgjedhjeve dhe filloi t'i postojë rezultatet preliminare sipas vendvotimeve në ueb-faqen e saj menjëherë pas mbylljes së votimit, gjë që e rriti transparencën.

KSHZ-ja dhe Ministria e Punëve të Brendshme raportuan për incidente të izoluara.²⁸ Zyra e Prokurorisë Publike të Shtetit njoftoi se kishte pranuar disa denoncime për sjellje të mundshme kriminale gjatë ditës së zgjedhjeve, më së shumti në lidhje me blerjen e supozuar të votave dhe presionin ndaj votuesve, si dhe kërcënimet drejtuar vëzhguesve qytetarë në mediat sociale, me ç'rast për të gjitha rastet është urdhëruar të bëhet hetim penal. KSHZ-ja dhe Zyra e Avokatit të Popullit kishin në funksion linja të posaçme telefonike ku votuesit mund të raportonin shkeljet dhe pengesat e mundshme të të drejtave të tyre të votimit. Deri në mbylljen e votimit, KSHZ-ja raportoi 739 kundërshtime nga votuesit në lidhje me të drejtën e tyre për të votuar: 642 prej tyre u miratuan. Një numër i KZK-ve e informuan MVZ-në e ODIHR-it se ato i kishin përcjellë kundërshtimet e tilla në KSHZ.

Pas shpalljes së rezultateve preliminare natën e zgjedhjeve, në një konferencë për mediat, Zoran Zaevi njoftoi dorëheqjen e tij si kryeministër dhe kryetar i LSDM-së.

***Versioni në gjuhën angleze i këtij raporti është dokumenti i vetëm zyrtar.
Janë siguruar edhe përkthime jozyrtare në gjuhën maqedonase dhe në gjuhën shqipe.***

²⁸ Në ditën e zgjedhjeve, MPB-ja njoftoi se e kishte shtuar praninë e policisë pas disa raportimeve për pengimin e procesit zgjedhor.

INFORMATA PËR MISIONIN DHE MIRËNJOHJE

Shkup, 1 nëntor 2021 – Vlerësim është bërë për të përcaktuar nëse zgjedhjet përputhen me angazhimet e OSBE-së dhe detyrimet dhe standardet tjera ndërkombëtare për zgjedhjet demokratike, si dhe me legjislacionin kombëtar. Ky vlerësim duhet të lexohet së bashku me Deklaratën për Gjetjet dhe Përfundimet Paraprake, të publikuar më 18 tetor pas ditës së zgjedhjeve të rrethit të parë.

ODIHR ka miratuar Deklaratën e parimeve për Vëzhgimin Ndërkombëtar të Zgjedhjeve të vitit 2005. Kjo Deklaratë e Gjetjeve dhe Përfundimeve Paraprake dorëzohet para përfundimit të procesit zgjedhor. Vlerësimi përfundimtar i zgjedhjeve do të varet, pjesërisht, nga zhvillimi i fazave të mbetura të procesit, duke përfshirë nxjerrjen dhe shpalljen e rezultateve, si dhe trajtimin e kundërshtimeve dhe ankesave të mundshme pas ditës së zgjedhjeve. ODIHR-i do të publikojë një raport gjithëpërfshirës përfundimtar, që përfshin rekomandimet për përmirësime të mundshme, tetë javë pas përfundimit të procesit zgjedhor.

Tana de Zulueta është shefe e MVZ-së së ODIHR-it, që filloi me punë më 7 shtator. Vëzhgimi i rrethit të dytë nga ana e MVZ-së së ODIHR-it përfshiu 13 ekspertë në kryeqytet dhe 10 vëzhgues afatgjatë. Vëzhguesit e ODIHR-it për rrethin e dytë erdhën nga 13 vende. Pesëmbëdhjetë vëzhgues të ODIHR-it ishin gra.

MVZ-ja e ODIHR-it dëshiron të falënderojë autoritetet për ftesën e tyre për të vëzhguar zgjedhjet, dhe Komisionin Shtetëror të Zgjedhjeve dhe Ministrinë e Punëve të Jashtme për ndihmën e tyre. MVZ-ja e ODIHR-it dëshiron po ashtu të shprehë falënderimin e saj ndaj institucioneve të tjera shtetërore, partive politike, kandidatëve, mediave, organizatave të shoqërisë civile, si dhe përfaqësuesve të bashkësisë ndërkombëtare për bashkëpunimin e tyre.

Për informata plotësuese ju lutemi kontaktoni:

- Tana de Zulueta, Shefe e MVZ-së së ODIHR-it në Shkup (+389 2 5518109);
- Katya Andrusz, Zëdhënësja e ODIHR-it, në Varshavë (+48 609 522 266), apo
- Keara Castaldo, Këshilltare për zgjedhjet e ODIHR-it, në Varshavë (+48 603 638 999).

Adresa e MVZ-së së ODIHR-it:

Hoteli luksoz Limak Shkup, kati 1

Rr. Jordan Mijalkov 31

1000 Shkup, Republika e Maqedonisë së Veriut

telefoni: +389-2-5518109; e-maili: office@odihr.mk